

VENDIM
Nr.641, datë 30.9.2004

**PËR LEJIMIN E NDËRMARRJES EKSPORT-IMPORT “MEICO” TIRANË, TË PËRDORË
PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, PËR BLERJEN E PJESËVE TË
KËMBIMIT PËR HELIKOPTERËT AB 205 DHE AB 206 TË MINISTRISË SË MBROJTJES
PËR VITIN 2004**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ndërmarrjes eksport-import “Meico” Tiranë që, për fondin limit prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “Agusta” S.p.A. Itali, për blerjen e pjesëve të këmbimit për helikopterët AB 205 dhe AB 206 të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2004.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano